



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 prill 2016
Nr. ref.:RK914/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI72/15

Parashtrues

Selim Hasani

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 51/2015, të 2 prillit 2014**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Selim Hasani, i cili përfaqësohet nga z. Zef Delhysa, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 51/2015, i 2 prillit 2015, me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa për revizion e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 542/2014, të 17 nëntorit 2014.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 21 maj 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe me nenin 17 të Deklaratës Universale për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: DUDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 5 qershor 2015, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 3 gusht 2015, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI72/15, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI72/15, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Artta Rama-Hajrizi.
8. Më 18 gusht 2015, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Supreme një kopje të kërkesës.
9. Më 23 shtator 2015, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë autorizimin e kërkuar.
10. Më 15 mars 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. I ati i parashtruesit të kërkesës kishte vdekur në vitin 1974. Në atë kohë, parashtruesi ishte banor i Shqipërisë. Në një ditë të pacaktuar, vëllai i parashtruesit të kërkesës ishte pranuar si trashëgimtar i vetëm dhe ai kishte trashëguar pronën e patundshme në fshatin Gërgoc.
12. Pas vdekjes së vëllait të parashtruesit në vitin 1997, pronën e paluajtshme në Prizren e trashëgoi bashkëshortja dhe fëmijët e tij. Pas vitit 1999, parashtruesi i kërkesës ishte kthyer në Kosovë.
13. Më 19 tetor 2004, në bazë të së drejtës në trashëgimi, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar konfirmimin e pronësisë mbi pronën e paluajtshme në Prizren. Parashtruesi pretendoi se kjo pasuri e paluajtshme në Prizren ishte blerë me të hollat e shitjes së pronës së paluajtshme në fshatin Gërgoc.
14. Më 8 nëntor 2004, parashtruesi paraqiti propozim në Gjykatën Komunale në Prizren për vendosje të masës së përkohshme, gjegjësisht të ndalojë palën e paditur (trashëgimtarët e vëllait të tij të vdekur) ta tjetërsojë pronën e paluajtshme derisa Gjykata Komunale në Prizren të nxjerrë vendim përfundimtar.
15. Më 25 janar 2005, Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi C. nr. 1448/04) vendosi ta miratojë propozimin e parashtruesit për masë të përkohshme.
16. Më 24 maj 2006, trashëgimtarët e vëllait të parashtruesit lidhën kontratën e shitblerjes me një palë të tretë. Kjo kontratë e shitblerjes u vërtetua nga Gjykata Komunale në Prizren (Aktvendimi Leg. nr. 2502/2006, i 24 majit 2006).
17. Më 13 korrik 2006, parashtruesi saktësoi kërkesëpadinë e tij, duke kërkuar nga Gjykata Komunale të anulojë kontratën e lartpërmendur të shitblerjes, të lidhur ndërmjet trashëgimtarëve të vëllait të tij dhe palës së tretë (pala e paditur) dhe të shpallë parashtruesin e kërkesës bashkëpronar të pasurisë së paluajtshme në Prizren.
18. Më 10 shtator 2013, Gjykata Themelore në Prizren (Aktgjykimi C. nr. 146/10) refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit për anulimin e kontratës së shitblerjes dhe vërtetimin e bashkëpronësisë si të pabazuar. Gjykata Themelore vendosi më tej se masa e përkohshme e vendosur me vendim (Aktvendimi C. nr. 1448/04, i 25 janarit 2005) mbetet në fuqi deri sa vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.
19. Gjykata Themelore, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi (neni 138 i Ligjit për Trashëgimi), konstatoi se *"[...] ai është kthyer në Kosovë nga Republika e Shqipërisë, menjëherë pas luftës, përkatësisht në mes të vitit 1999, për çka edhe del se ai në këtë kohë ka kuptuar për 'shitjen' e paluajtshmërive të të ndjerit [vëllait], përkatësisht për 'blerjen' e paluajtshmërisë kontestuese në Prizren, ndërsa padia e tij është paraqitur pranë kësaj gjykate në fund të vitit 2004, që i bie pas kalimit të afatit ligjor subjektiv 1-vjeçar. Përpos kësaj, me shikim në shkresat e lëndës, del se [parashtruesi i kërkesës] dhe i ndjeri [...]"*

janë vëllezër, janë djemtë e të ndjerit [...], i cili ka ndërruar jetë në vitin 1974, që do të thotë se në këtë çështje kontestimore ka kaluar edhe afati objektiv 10-vjeçar, përkatësisht ai 20-vjeçar për poseduesin me keqbesim, sepse konform dispozitave ligjore të lartcituara, koha a llogaritjes për të kërkuar pasurinë trashëgimore për [parashtruesin] ka filluar të rrjedhë nga momenti i vdekjes së të atit të tij [...]”.

20. Sa i përket kontratës së shitblerjes, të lidhur më 24 maj 2006, Gjykata Themelore konstatoi se blerësi ka hyrë në marrëdhënie kontraktuese në mirëbesim dhe se *“[...] ky kontest nuk mund t'i bart pasojat apo keqkuptimet eventuale që ekzistojnë apo kanë ekzistuar në mes të [parashtruesit të kërkesës] dhe [trashëgimtarit të vëllait të parashtruesit të kërkesës]*”.
21. Në lidhje me çështjen e masës së përkohshme, Gjykata konkludoi se nuk është detyrë dhe obligim i palëve kontraktuese të jenë në dijeni për kufizimet e mundshme që mund të ekzistojnë në pasuritë e paluajtshme. Sipas Gjykatës Themelore, detyra dhe obligimi për të respektuar kufizime të tilla qëndron te autoritetet publike kompetente për vërtetimin e kontratave të tilla.
22. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, parashtruesi ushtroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, parashtruesi pretendoi shkelje esenciale të ligjit procedural, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
23. Më 17 nëntor 2014, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 542/2014) refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.
24. Gjykata e Apelit konstatoi se pretendimet e parashtruesit, të ngritura në ankesën e tij, tashmë ishin adresuar nga gjykata e shkallës së parë, që rezultoi që Gjykata Themelore kishte vlerësuar drejt gjendjen faktike dhe kishte zbatuar drejt të drejtën procedurale dhe materiale.
25. Gjykata e Apelit, në aktgjykimin e saj, konfirmoi se *“blerësi i kësaj patundshmërie është blerës i ndërgjegjshëm dhe i njëjti e fiton të drejtën e pronësisë po qe se nuk ka ditë dhe nuk ka qenë dash të din se shitësi nuk është pronar. Blerësi në këtë patundshmëri ka fituar pronësinë në bazë të punës së vlefshme juridike në mënyrë të ndërgjegjshme. Në kontekst me këto, pretendimet ankimore paraqiten si relevante dhe të pabazuara në këtë çështje juridike*”.
26. Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, parashtruesi ushtroi revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar shkelje esenciale të së drejtës procedurale, vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Përveç kësaj, parashtruesi ngriti çështjen e masës së përkohshme, për të cilën ai pretendonte se ishte ende në fuqi.
27. Më 2 prill 2015, Gjykata Supreme (Aktgjykimi, Rev. nr. 51/2015) refuzoi revizionin e parashtruesit si të pabazuar.

28. Gjykata Supreme gjeti se gjykatat e instancave më të ulëta, në bazë të vlerësimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, kanë zbatuar drejt të drejtën procedurale.
29. Sa i përket zbatimit të së drejtës materiale, Gjykata Supreme, bazuar në dispozitat e Ligjit për Trashëgimi, konfirmoi se e drejta e parashtruesit të kërkesës për të kërkuar trashëgiminë ishte objekt i parashkrimit.
30. Prandaj, në lidhje me këtë, Gjykata Supreme konstatoi se gjykatat e shkallës më të ulët gjithashtu kanë zbatuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale.
31. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës lidhur me çështjen e masës së përkohshme të vendosur nga Gjykata Komunale, Gjykata Supreme konsideron se gjykata e shkallës më të ulët ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore, përkatësisht, nëse gjykata e shkallës së parë nuk e miraton kërkesëpadinë, masa e përkohshme mbetet në fuqi deri sa vendimi i gjykatës së shkallës së parë të marrë formë të prerë.
32. Në fund, Gjykata Supreme konkludoi se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit ishte i qartë dhe i kuptueshëm dhe se ai përmban arsye të mjaftueshme dhe fakte vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesi pretendon se i ishte mohuar e drejta e tij për gjykim të barabartë. Përveç kësaj, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij në pronë. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe as nuk ka shpjeguar se si dhe pse janë shkelur të drejtat e lartcekura kushtetuese.
34. Në kërkesën e tij, parashtruesi i kërkesës kryesisht ankohet për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta. Përveç kësaj, ai gjithashtu pretendon vlerësim të gabuar të gjendjes faktike. Në këtë drejtim, ai pretendon se, në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, *“lidhur me refuzimin e ankesës sa i përket kërkesës për anulimit e kontratës së lartcekur [kontrata e shitblerjes] është edhe më i çuditshëm. Në vend të konstatimit të pandërgjegjësisë të të paditurve, përgjegjësinë e tyre dhe të gjykatës, në kuptim të ‘legalizimit’ të kontratës të palejuar, gjykata e shkallës së dytë, të cilës i është besuar të kujdeset për ligjshmërinë dhe sundimin e ligjit, ajo ‘i mbyllë sytë’ para faktit të papranueshëm dhe të kundërligjshëm, duke shpallur blerësin të ‘ndërgjegjshëm’ [...]”*.
35. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata që të anulojë aktgjykimet e Gjykatës Supreme, të Gjykatës së Apelit dhe atë të Gjykatës Themelore në Prizren, si antikushtetuese dhe ta kthejë lëndën për rigjykim.

Pranueshmëria e kërkesës

36. Në mënyrë që të jetë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
37. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar në bazë të Kushtetutës, se e konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht aktgjykimin e Gjykatës Supreme, se i ka shteruar mjetet e nevojshme juridike dhe ka parashtruar kërkesën brenda periudhës prej 4 (katër) mujor.
38. Parashtruesi i ka përmendur në mënyrë të qartë të drejtat kushtetuese dhe liritë që pretendohen se i janë shkelur dhe ka përmendur aktin e kontestuar, siç kërkohet me nenin 48 të Ligjit, i cili parasheh:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë”.

39. Gjykata më tej duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e Rregullores së punës, përkatësisht të rregullit 36 (2), i cili parasheh:

“(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose

[...]

d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Siç u theksua më lart, parashtruesi pretendon shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës së tij në pronë.
41. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk e ka dëshmuar pretendimin për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të së drejtës në pronë. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqesë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin nr. KI198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Gjykata Kushtetuese, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014).
42. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi nuk pajtohet me vlerësimin e fakteve dhe me zbatimin e dispozitave procedurale dhe ligjore nga gjykatat e rregullta. Vlerësimi i fakteve dhe ligji i zbatueshëm janë çështje të cilat bien brenda fushës së ligjshmërisë.

43. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit apo të ligjit (ligjshmërinë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë).
44. Prandaj, Gjykata thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih rastin *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
45. Siç u theksua më lart, Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, konkludoi se në bazë të vlerësimit të drejtë të gjendjes faktike, e drejta procedurale dhe materiale janë aplikuar në mënyrë të drejtë.
46. Përveç kësaj, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata ka gjetur se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendim i 30 qershorit 2009).
47. Në fund, Gjykata thekson se parashtuesi i kërkesës nuk ka paraqitur asnjë argument bindës që do të vërtetonte se shkeljet e pretenduara, të përmendura në kërkesë, përbëjnë shkelje të të drejtave kushtetuese (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).
48. Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtuesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese dhe se parashtuesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
49. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, më 15 mars 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Ivan Čukalović

Arta Rama-Hajrizi

